

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rusia mohon përfshirjen në dronin me eksplozivë, Lavrov: Kjo është rruga drejt një lufte të vërtetë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/rusia-mohon-perfshirjen-ne-dronin-me-e-lavrov-kjo-eshte-rruga-drej-i584295
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 13:01:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 13:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0de17812cc784a7b89e1c48c3b1dd9a5e68d2da4f4f0d7f0dc9672dfc3c263f7
TEKSTI	f8cfbfd326a9d57f06673709d6f0e4d3d53136c5c6f287aa92946ff1991bbcc3
PAMJA	c9959b6e5956840b28b870f2fecb006fe313f4b6730729c0806fc634d7369cae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f89b45cb59700a8284adf72bb14c9d61737331e5018fb54bcf7ca396385c3d04
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	475d518598164a6fca4ccfef21e2861f646caa940cdcee184ece19d66f24a93c
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmdKiUsbe1dzvDLxvAjpyRejoijFNmdMrnWrgD5SJRvybp



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f89b45cb59700a8284adf72bb14c9d61737331e5018fb54bcf7ca396385c3d04>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1 e [Kuhizimet e GJKKO ndaj medias, reagon BE: Po e monitorojme nga afer ne kuader te negociatave te anetaresimit i BE-se; Rusia dergoi temije u krainas te rrem fundit](#)

Rusia mohon përfshirjen në dronin me eksplozivë, Lavrov: Kjo është rruga drejt një lufte të vërtetë



6 Shtator 2026, 15:35 Bota TEMA



Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka hedhur poshtë akuzat gjermane për përfshirjen e Moskës në incidentin me një dron të pajisur me eksplozivë në aeroportin e Leipzigit dhe ka paralajmëruar se pretendimet kundër Rusisë mund të çojnë në një përshkallëzim serioz.

“Akuzat kundër Rusisë janë fillimi i një lufte të vërtetë”, deklaroi Lavrov, duke i cilësuar pretendimet e Berlinit si një provokim të nxituar.

Incidenti në aeroportin Leipzig/Halle është kthyer në një çështje të ndjeshme mes Gjermanisë dhe Rusisë. Autoritetet gjermane dyshojnë se droni i zbuluar pranë një avioni transporti ukrainas kishte karakteristika të teknologjisë ruse dhe ishte i ngarkuar me eksplozivë.

Hetimet gjermane kanë çuar deri tani te dy persona të dyshuar për përfshirje në operacion. Njëri prej tyre është një burrë me origjinë ruse dhe pasaportë letoneze, i cili dyshohet se ka koordinuar operacionin dhe se ka kontakte me shërbimet sekrete ruse.

Sipas mediave gjermane, ai kishte hyrë në Gjermani përmes aeroportit të Berlinit dhe më pas kishte udhëtuar drejt Leipzigit me një makinë me qira. Pas incidentit, ai ishte larguar përsëri nga Gjermania.

Hetuesit kanë përdorur edhe prova biologjike për të identifikuar një të dyshuar të dytë. Gjurmë ADN-je u gjetën në një prej dronëve, brenda një ene metalike me eksplozivë, si dhe në një antenë të vendosur pranë aeroportit.

Sipas autoriteteve, antena mund të jetë përdorur për të përforcuar sinjalet e telefonisë celulare që shërbenin për kontrollin e dronëve.

Krahasimi i materialit gjenetik me bazat e të dhënave evropiane çoi hetuesit te një burrë me origjinë bjelloruse, i cili gjithashtu disponon pasaportë ruse. Autoritetet kanë rindërtuar lëvizjet e tij në Gjermani dhe dyshohet se ai kishte hyrë në vend me një vizë turistike italiane.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, autoritetet gjermane mbeten të kujdesshme në lidhje me përfshirjen e mundshme të Rusisë dhe mundësinë për të çuar të dyshuarit përpara drejtësisë.

Moska mohon çdo përfshirje në incident. Ambasada ruse në Berlin e ka cilësuar rastin si një “provokim të nxituar” dhe ka shprehur shqetësim për atë që e quan

një valë të re të "histerisë anti-ruse" në Gjermani.

Qështja pritet të rrisë më tej tensionet mes Berlinit dhe Moskës, në një kohë kur Gjermania dhe aleatët e saj po përballen me një sërë akuzash për aktivitete të dyshuara ruse në territorin evropian.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut

14:45 Bota

"Rrezik për një tjetër Irak ose Afganistan" - Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes: Trump e ka futur veten në një ngërç, SHBA duhet të ndryshojë strategji për ta fituar luftën

14:35 Bota

["Dekolonizim" apo censurë? Qyteti rusishtfolës i Odesës përgatit kufizime të reja ndaj gjuhës ruse në art dhe kulturë](#)

13:35 Bota / 1 koment

Tragjedi në Kepin e Gjellbër, autobusi me studentë bie nga 30 metra! Të paktën 21 viktima

13:15 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.